



A.nr.601/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.601/2026 të datës 05.06.2026, të parashtruar nga ankuesi D.L, nga Gjilani kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike ‘*kontestim konkursi*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.601/2026 e datës 05.06.2026, e parashtruar nga ankuesi D.L.

A r s y e t i m

Ankuesi D.L (me tej referuar vetëm ankuese), më datë 05.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 601/2026, kundër vendimit lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën e punës Asistent Administrativ në Qendrën për Regjistrimin e Automateve në Gjilan të shpallur nga MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.06.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit, më datë 19.06.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2572/2026 të datës 05.06.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 26.04.2026; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Akt emërimit me numër 3800 të datës 26.12.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.06.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 19.06.2026; Konkursin e datës 31.03.2026; Listën e aplikanteve; Vendimin me numër 1041 të datës 15.05.2026; Njoftimin me numër 1229 të datës 29.05.2026; Aplikacionin e ankuesit së bashku me dosjen e bashkangjitur me rastin e aplikimit në pozitën e punës Asistent Administrativ në Qendrën e regjistrimit të automjeteve në Gjilan.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme me datë 31.03.2026, ka shpallur konkursin me numër reference RN00019531 për pozitën e punës ‘Asistent Administrativ’ në Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Qendra e Regjistrimit të automjeteve në Gjiilan.

Ankuesi me datë 05.06.2026 parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kundër Vendimi lidhur me refuzimin e aplikimit për pozitën në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Gjiilan, konkurs i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.. si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: Ankesa në procedurë pranimi. 1. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve dhe rrjedhimisht konstatoi se kandidati për pranim në Shërbim Civil, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtuar me datë 05.06.2026, dhe si rrjedhojë nga shkresat e lëndës konstatohet se procedura e rekrutimit sipas konkursit me referencë RN00019531 për pozitën e punës ‘Asistent Administrativ’ në Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Qendra e Regjistrimit të automjeteve në Gjiilan, është në proces, po ashtu me datë 08.07.2026 U.D Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPB përmes emailit na njofton dhe se me datë 07.07.2026 është shpallur njoftimi lidhur me kandidatet që kanë kaluar testin me shkrim, andaj mbi bazën e kësaj rezulton së ankesa e ankuesit është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë/Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.nr 601/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit D.L;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së